



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3579 Prot

Lezhë, më 30 / 3 /2023

VENDIM

Nr. 21, Datë 29 . 03 .2023

“Për miratimin e listës së pjesshme paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohet në pronësi të Nj. A. Ungrej, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, për pasurinë sipas inventarit me emërtim Ranishte, Fshati Gjobardhaj dhe Fshati Kalivaç, Nj. A. Ungrej”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 gërma a, në ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” neni 8, i ndryshuar, ligjin nr. 8744 date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Neni 2, Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Seksioni IV, Ligji 111/2018 “Për Kadastrën” Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24, Udhëzimin nr 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar), Udhëzimin nr 15 dt 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, të VKM nr 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin nr 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

- 1.Miratimin e listës paraprake të pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Nj. A.Ungrej, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.
 - a.Lista e inventarit bashkëngjitur, Fshati Gjobardhaj, Fshati Kalivaç, Nj.A.Ungrej, Bashkia Lezhë.
- 2.Paraqitjen e listës së pjesshme paraprake për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



I. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE

(Për Inventarizimin e Pronave të Vecanta)

<p>BASHKIA LEZHË, NJ. Ad. Ungrej.</p> <p>Identifikoi <u>Ing. Nderim Mucai. (Topograf)</u> <i>[Signature]</i> (Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)</p> <p>Supervizoi <u>Gjiek Makaj (Drejtori i Kadastrës & S.M.A.)</u> <i>[Signature]</i> (Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)</p> <p>Aprovoi <u>Pierin Ndreu (Kryebashkiaku)</u> (Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar) <i>[Signature]</i></p>										
<p>Fusha e Përdorimit të Pronës : Burime Natyrore.</p>		B				C				
Nr rendor	A		B			C			Të dhëna të tjera të (Shënime të Vecanta)	
	Zona Kadastrale & Indeksi i Hartës	Nr i Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës, Adresa	Sip Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip Totale sa Ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilën Përdoret Prona	Institucioni / Enti me SHK Përgjegjës Administrative		Institucioni / Enti Statusi Juridik i Përdorimit
1	2043	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	K-34-76-(57-A,57-B,57-C,57-D)	176/3-B	Ranishite	Ranishite, Fshati Kalivac	377651	0		Bashkia Lezhë	Bashkia Lezhë	
2	1747	175/3-A	Ranishite	Ranishite, Fshati Gjobardhaj	258770	0		Bashkia Lezhë	Bashkia Lezhë	

Nr. 35781, prot.



C. M.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 281/6 Prot.

Lezhë, më 03.04.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, ligjin nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 3, datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore" si dhe Udhëzimit nr. 15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 21, datë 29.03.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e listës së pjeshme paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohet në pronësi të njësisë administrative Ungrej, bashkia Lezhë, qarku Lezhë për pasuritë sipas inventarit me emërim ranishte, fshati Gjobardhaj dhe fshati Kalivaç Nj. A. Ungrej".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

